



Të dhënat e Shqipërisë për të drejtat e njeriut vlerësohen nga Rishikimi Periodik Universal

GJENEVË (30 tetor 2024) - Të dhënat e Shqipërisë për të drejtat e njeriut do të vlerësohen nga Grupi i Punës i Rishikimit Periodik Universal (UPR) i Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për herë të katërt, ditën e hënë më 4 nëntor 2024, gjatë një mbledhjeje në Gjenevë që do të [transmetohet drejtpërsëdrejti në internet](#).

Shqipëria është një prej 14 Shteteve që do të vlerësohen nga Grupi i Punës i UPR-së gjatë sesionit të ardhshëm nga data 4 deri 15 nëntor 2024. [Rishikimi i parë, i dytë dhe i tretë nga UPR-ja](#) për Shqipërinë u mbajtën në dhjetor të vitit 2009, prill të vitit 2014 dhe maj të vitit 2019, përkatësisht.

Grupi i Punës i UPR-së përfshin 47 Shtete Anëtare të Këshillit të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, secili prej 193 Shteteve Anëtare të OKB-së mund të marrë pjesë në rishikimin e vendeve.

Dokumentacioni mbi të cilin bazohen rishikimet përfshin: 1) raportin kombëtar - informacion i siguar nga Shteti që shqyrtohet; 2) informacionin e përfshirë në raportet e ekspertëve dhe grupeve të pavarura të të drejtave të njeriut, që njihen si procedura të veçanta, organeve të traktateve të të drejtave të njeriut dhe organeve të tjera të OKB-së; 3) informacionin e siguar nga palë të tjera interes, përfshirë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, organizatat rajonale dhe grupet e shoqërisë civile.

Këto tre **raporte** që përbëjnë bazën e shqyrtimit të Shqipërisë më 4 nëntor janë të disponueshme [këtu](#).

Vendndodhja: Salla 20, Palais des Nations, Gjenevë

Ora dhe data: 14:30 – 18:00, e hënë, 4 nëntor 2024 (ora e Gjenevës, GMT+1).

UPR-ja është shqyrtim mes palëve i të dhënave për të drejtat e njeriut për të 193 Shtetet Anëtare të OKB-së. Që prej mbledhjes së parë të mbajtur në prill të

vitit 2008, të 193 Shtetet Anëtare të OKB-së janë shqyrtuar tre herë. Pritet që edhe gjatë ciklit të katërt të UPR-së Shtetet të shprehin hapat e ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë shqyrtimeve të mëparshme, për të cilat kanë marrë angazhim ndjekjeje, dhe të theksojnë zhvillimet e kohëve të fundit në vend sa i përket të drejtave të njeriut.

Delegacioni i Shqipërisë do të kryesohet nga Znj. Megi Fino, Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Tre përfaqësuesit e shteteve që do të luajnë rolin e relatorëve ("troika") për shqyrtimin e Shqipërisë janë përfaqësuesit e Ganës, Japonisë dhe Bullgarisë.

Transmetimi në internet "**webcast-i**" i sesionit mund të ndiqet në:

<https://webtv.un.org/en/asset/k1s/k1sj0lasva>

Lista e folësve dhe të gjitha deklaratat e disponueshme që do të mbahen gjatë shqyrtimit të Shqipërisë do të publikohen në [Faqen publike të internetit të UPR-së](#).

Është planifikuar që Grupi i Punës i UPR-së të **miratojë rekomandimet** e bëra në drejtim të Shqipërisë, ditën e premte më 8 nëntor 2024, nga ora 15:30 deri në orën 18:00 (GMT+1). Shteti nën shqyrtim mund të dëshirojë të shprehë qëndrimin e vet lidhur me rekomandimet e ngritura gjatë shqyrtimit.

// FUND //

Për më shumë informacion dhe kërkesa nga media, ju lutemi kontaktoni Pascal Sim, Zyrtar për Median, në simp@un.org, David Díaz Martín, Zyrtar për Informacionin Publik në david.diazmartin@un.org, dhe Matthew Brown, Zyrtar për Informacionin Publik, në Matthew.Brown@un.org

Për më shumë informacion rreth Rishikimit Periodik Universal, vizitoni:

www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/upr-main

Abonohuni në Buletinin Informativ të Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut

në: <https://mailchi.mp/a3a538479938/hrc-mailshot-to-ohchr-global>

Na ndiqni në mediat sociale:

[Facebook](#) | [X](#) | [YouTube](#) | [Instagram](#)